



Data/Datum/Date:	07.11.2024
Nr./Br./No	12/35
Nga/Od/From:	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gjart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Vendim për anulim të përfshirjes publike për aplikim

Duke u bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nëni 50 dhe nëni 53 pika 3 dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe duke u mbështetur në Rregulloren Npi/01-228 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transferëve dhe në pajtim me Statutin e Komunes së Shtimes, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, merr këtë:

### VENDIM

Për anulimin e pjesës së thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 12/19 të datës 29.08.2024, për kategorinë e kultivatorëve të projektit "Dhurimi i granteve bujqësore për ekonomitë familjare në territorin e Komunes së Shtimes", Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural bën të ditur se:

### ARSYETIM

Në kuadër të bashkëpunimit me Fondacionin Amaneti që janë palë në këtë projekt, është vlerësuar e nevojshme kohë shtesë për subvencionet e kultivatorëve që do t'u shpërndahen në familjeve në nevojë. Kjo bëhet për të siguruar që subvencionet e kultivatorëve të përgaditen në mënyrë sa më efektive dhe të shpërndahen tek familjet që kanë më së shumti nevojë. Kjo kohë shtesë është e domosdoshme për të garantuar që ndihma të jetë pa vonesa të tjera, andaj është nevojshme që të bëhet rivelesimi dhe rishpallja e thirrjes publike për aplikim për kultivator.

Të gjitha aplikimet e pranuar deri më tani për kategorinë e kultivatorëve nuk do të konsiderohen të vlefshme dhe përmes publikimit të këtij vendimi, do të njoftohen të gjithë aplikantët për anulimin e thirrjes.

Thirrja për aplikim për kategoritë e tjera të përfshira në projekt do të vazhdojnë siç është parashikuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të komunës së Shtimes.